

## PROCESVERBAL I TAKIMIT TË BORDIT INDUSTRIAL (BI)

Takimi i dytë i Bordit Industrial të FShJM

**Data:**

26.10.2023

**Fillimi:**

10:00

**Përfundimi:**

12:00

**Lokacioni:**

Salla e Senatit, Universiteti i Prizrenit

### Pjesëmarrësit:

1. Albana Milaimi, u.d. Dekane e FShJM
2. Besim Loshaj, Agroprodukt shpk, zëvendëskryetar i BI
3. Evelina Leka, Federata e Gjuetarëve të Kosovës
4. Skender Kokollari, u.d. Sekretar në FShJM
5. Nehat Gashi, Koordinator i Qendrës së Karrierës dhe Alumni
6. Arta Rrustemi, u.d. Udhëheqëse e Aktivitetit
7. Ariel Shaban, Specialist i Marrëdhënieve me Industrinë
8. Cassie Barnhardt, Drejtore e Aktivitetit *Private Sector Partnerships to Strengthen Higher Education*
9. Zoie Schares, Menaxhere e Lartë e Aktivitetit
10. Ardi Mejzini, Menaxher i Komunikimit
11. Denur Paçaku, Asistent i Programit

## PËRSHKRIMI I TEMAVE TË TRAJTUARA DHE KONKLuzionET

### I) Kosova Learn

Takimi i dytë i BI të FShJM u hap nga dekanja e fakultetit, Albana Milaimi, e cila në fillim të tij tha se i kishte ftuar edhe dy anëtarë të rinj të marrin pjesë në BI mirëpo nuk kanë pasur rast të vijnë. Ky takim u vazhdua me prezantimin e Kosova Learn nga Ardi Mejzini, i cili shpjegoi mënyrën formimit të platformës, qëllimin dhe targetin e saj. Për të, ai tha se gjithçka po shkon mirë sa i përket Kosova Learn e se kjo ka benefitet e veta meqë kompanitë private kanë gatishmëri për të pranuar studentë të rinj që kanë shkathtësi të buta, angazhime në mentorime dhe zhvillim të kapaciteteve profesionale. Sa i përket promovimit të platformës, Albana Milaimi përmendi pjesëmarrjen e saj në sesionin informues me studentët e FShJM-së dhe procedurën e regjistrimit të studentëve në të.

Ndërlidhur me platformën, Besim Loshaj tha se fillimisht ajo po duket mirë në atë që shihet, mirëpo mund të ketë edhe më shumë komente nëse e analizojmë më thellë. Sa i përket funksionimit të saj, Evelina Leka mori një shembull kur ajo ishte pjesë e një përgatitjeje të ngashme të GIZ, mirëpo tha se aty nuk ka pasur diçka të veçantë p.sh. nuk ka qenë mënyra online siç është në Kosova Learn. Ajo gjithashtu shprehi idenë që certifikimi nga kjo do të duhet të shërbejë pozitivisht, meqë nga certifikata që ajo kishte në marrë në trajimin e përmendur nuk është se ka mundur të përfitojë ndonjë gjë konkrete.

Sa i përket platformës, ndërlidhur me të Cassie Barnhardt tha se 40% e studentëve marrin pjesë në punë praktike me përvojë. Për këtë, dekanja Albana Milaimi tha sse FShJM është i kyçur në tre projekte të tjera, dhe se është e nevojshme të gjendet një strategji për nxitjen e studentëve në përfshirje në platformë. Rreth kësaj, Besim Loshaj tha se është mirë që po largohemi pak nga mësimi klasik.

### II) Diskutim në BI

Pas diskutimit mbi platformën Kosova Learn, u vazhdua me diskutimit sa i përket pikave në agjendën e parapare të BI. Për këtë, ndër të tjerash Ariel Shaban e pyeti Cassie Barnhardt se çfarë e nxit një kompani private të marrë pjesë në një Bord Industrial. Me këtë rast, Cassie Barnhardt u përgjigj se p.sh. një nga rastet mund të jetë mbajtja e takimeve/ mbledhjeve të BI në qendrat apo selitë e kompanive private. Gjithashtu çështje tjetër është relacioni personal dhe komunikimi me pjesëmarrësit. Veç tjerash, sa i përket funksionimit të BI:

- Dekanja Albana Milaimi tha se kompanitë private nuk marrin pjesë në BI, shkak i asaj që ata ndonjëherë nuk kanë kohë meqë janë të angazhuar me punë. Më pas, veç kësaj, arsye tjetër është edhe largësia e pjesëmarrësve në bord nga vendi se ku mbahet dhe mungesa e incentivave.
- Besim Loshaj tha se ftesat duhet t'i dërohen drejt pronarëve të kompanive (p.s. kjo është ajo që veç e kemi bërë). Ka nga punëtorë nga kompanitë të cilët nuk kanë kualifikim apo qasje për probleme të ndryshme. Ai thotë se kompanitë kanë më shumë përqëndrim në profit.
- Besim Loshaj thotë se ka rëndësi që të krijohet një vetëdije apo të mërret një model p.sh. nga shtetet e perëndimit për atë se si funksionojnë BI, apo programet përkatëse.
- Evelina Leka mendon se bizneseve/ kompanive private duhet t'i jepet një lëvdatë/ falënderim për kontributin e tyre.
- Albana Milaimi propozoi ndonjë incentivë, pagesë e rrugës apo mëditje për kompanitë private.
- Besim Loshaj mendon se jo çdonjëri e kupton qëllimin e BI. Ai tha se është mirë që të takohet dikush me pronarët e kompanive dhe t'ua sqarojë se jo gjithçka është materiale dhe se është me rëndësi të marrin pjesë kompanitë private.
- Ariel Shaban thotë se është rritur regjistrimi/ interesimi për studimet në fushën e bujqësisë në Universitetin e Pejës, arsyeja se ata e dinë se pas studimeve kanë mundësi më të madhe të puësnohen.

### III) Corporate Panels

Pas diskutimit për dy nëntemat më lart, në vijim pjesëmarrësit kanë biseduar edhe për Corporate Panels. Lidhur me këtë, u pyet:

- Nga Besim Loshaj nëse duhet që anëtarët e paneleve të korporatave të jenë pjesë e Bordit Industrial. Në vazhdim të kësaj ai inkurajoi që fokusi të jetë në bizneset afër Prizrenit.
- Albana Milaimi tha se kemi nevojë që ta mbajmë një mbledhje në BI në mënyrë të veçantë (d.m.th. pa PSPSHE), që të flasim dhe më pas t'i anëtarësojmë dy kompanitë tjera.

### IV) Prezantimi i të dhënave preliminare nga hulumtimi

- Në vazhdim të diskutimit, Ariel Shaban prezantoi të dhëna preliminare të hulumtimit mbi numrin e studentëve të regjistruar, aktivë e të pranuar dhe krahasimin e trendit të bazuar në të dhëna. Me këtë rast, një nga të dhënat interesante ishte që studentët e FShJM, përkatësisht të programit të studimeve Agrobiznes, regjistrojnë vitin e parë të studimeve e më pas nuk diplomojnë, pra merr një kohë të gjatë deri në diplomim.
- Ndërlidhur me paragrafin më lart, Dekanja e FShJM-së, Albana Milaimi, u përgjigj se kjo çështje është prezente dhe tri arsyet kryesore të saj janë: migrimi pas vitit të parë të studimeve; studentëve nuk u pëlqen programi i studimeve dhe nuk e shohin vetën në të ardhmen në këtë fushë; dhe disa prej studentëve regjistrohen në vitin e parë të studimeve vetëm me qëllim që të përfitojnë bursë në vlerë prej 1000 € dhe më pas i braktisin studimet.
- Cassie Barnhardt tha se ka rëndësi të grumbullohen të dhënat dhe të shtyejmë para diplomimin e atyre studentëve që regjistrohen.

### V) Prezantimi nga Qendra e Karrierës dhe Alumni

- Nehat Gashi prezantoi për funksionimin e Qendrës së Karrierës dhe Alumni dhe raportin e saj me universitetin dhe kompanitë private.
- U prezantua puna e zyrës, trajnimet, forma, pjesëmarrësit dhe organizimi i start-up-eve.
- Bashkëpunimi i zyrës me BI ka qenë sipërfaqësor.
- Nehat Gashi tha se është vetëm një person që punon në zyrë dhe është pak sa e vështirë për të. Në vijim të këtij diskutimi, Cassie Barnhardt tha se këtë punë p.sh. në USA do ta kryenin 12-15 punëtorë. Ndërlidhur me këtë, ajo e përmendi se në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të aktivitetit dhe Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" (UPZ), do të punësohet edhe një punëtor në Qendrën e Karrierës dhe Alumni.

- Lidhur me punën praktike nga studentët, Albana Milaimi thotë se është e vështirë që studentët të bëjnë punë praktike në qytetet tjera, meqë kjo ka kosto të transportit.
- Besim Loshaj thotë se ideja që bizneset t'i paguajnë për punën praktike që bëjnë është ide shumë e mirë por shqetësuese se si do të zhvillohet. Ai tha se praktikantët i paguan pas dy muajve në vlerë rreth 200-250 € dhe varësisht angazhimit të tyre ata mund edhe të punojnë për një kohë më të gjatë.
- Evelina Leka tregon për kohën kur ajo si studentë ka qenë e angazhuar me punë praktikë në kopmaninë ETC/ Elkos dhe është paguar 5 € për një ditë pune. Ajo thotë se rëndësi për të kishte të merrte përvojë pune.
- Në fund, Ariel Shaban përmbledhi pikat e diskutimit dhe detajet për takimin e ardhshëm të BI.

#### AKTIVITETE TË PLANIFIKUARA (NËSE KA)

	AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	AFATI I FUNDIT
1	Dërgimi i të dhënave përfundimtare të studentëve aktivë, të regjistruar dhe të diplomuar për FShJM.	Albana Milaimi, Denur Paçaku	31.10.2023

#### Denur Paçaku

Pogram Assistant,  
Private Sector Partnerships to Strengthen Higher Education,  
USAID Grantee,  
Iowa Consortium, University of Iowa,  
Prizren, Kosovo, 20 000 (GMT +2),  
Mobile: +383 48 265 012.

# IOWA